

# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

## NDËRMJET

**AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (AMF)**

DHE

**BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
(BQK)**

PËR

**BASHKËPUNIMIN RECIPROK NË KUADËR TË RREGULLIMIT DHE  
MBIKËQYRJES SË TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE**

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë (AMF),  
i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv,  
dhe  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK),  
e përfaqësuar nga Guvernatori,**

të cilët këtu e më poshtë do të quhen "Palë", angazhohen të kenë bashkëpunim të ndërsjelltë, shkëmbim informacioni, si dhe shkëmbim të eksperiencave dhe praktikave më të mira sikurse citohet më tej në këtë Memorandum Mirëkuptimi, për të lehtësuar kryerjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Nëpërmjet këtij Memorandumi, Palët bien dakord si më poshtë:

**Neni 1**

**Qëllimi i Memorandumit**

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është vendosja e një sistemi bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni midis palëve, në funksion të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve përkatëse.

Bashkëpunimi reciprok, bazuar në rëndësinë e zhvillimit të tregjeve financiare të të dy vendeve, do të shtrihet në:

- a. Tregjet e sigurimeve / risigurimeve ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit si dhe zhvillimi i Kolegjeve Mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, në funksion të mbikëqyrjes së integruar me bazë rreziku në nivel grupi për shoqëritë që kanë aktivitete në të dy vendet nënshkruese të këtij Memorandumi.



- b. Tregjet e kapitalit, fondeve të pensioneve vullnetare, dhe fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe veprimtarisë së këtyre tregjeve;
  - c. Aktivitete të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve nga ligjet e veçanta të fushës.
2. Ky Memorandum shërben si bazë për bashkëpunimin midis Palëve dhe nuk cënon asnjë detyrim ligjor sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të nënshkuara me Palë të treta.
  3. Zbatimi i këtij Memorandumi do të bëhet brenda disponueshmërisë së burimeve respektive të Palëve, në përputhje me legjislacionin vendas dhe interesat publike të shteteve të Palëve përkatëse.

## Neni 2

### Fushat e Angazhimit / Modalitetet e Bashkëpunimit

1. Palët angazhohen të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm, apo të bashkëpunojnë për të ndihmuar njëra-tjetrën në kuadër të funksioneve të tyre të rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes. Në rast se informacioni i kërkuar nga njëra Palë nuk disponohet nga Pala tjetër, kjo e fundit angazhohet të bëjë të gjitha përpjekjet ligjore për ta siguruar informacionin e kërkuar.
2. Në rast se kërkesa për informacion lidhet me subjekte të veçanta, apo aktivitete që ato kryejnë, Pala marrëse e kërkesës angazhohet të mbështesë palën që kërkon informacionin. Në rast se ka vështirësi në mbledhjen e informacionit të kërkuar, Palët shqyrtojnë mundësinë e konsultimit me njëra-tjetrën.
3. Mbështetja në dhënien e informacionit dhe bashkëpunimit kryhet në përputhje me legjislacionin e vendit të Palës që merr kërkesën, përfshirë këtu marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.
4. Palët mund të bien dakord për organizimin e inspektimeve të përbashkëta në rastet kur njëra Palë mund të ftojë përfaqësues të Palës tjetër për të marrë pjesë në

inspektimin e grupit, filialit, degës apo zyrës së përfaqësimit të subjekteve të rregulluara në juridiksionin e Palës tjetër.

5. Palët angazhohen në hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta që synojnë asistencë, shkëmbimin e përvojës dhe trajnimin e punonjësve të tyre sipas nevojave.
6. Palët angazhohen të organizojnë takime të rregullta për të diskutuar mbi zbatimin e këtij Memorandumi dhe për të adresuar çështje të vendosjes dhe zbatimit të standardeve dhe çështje të veçanta të mbikëqyrjes në të dy vendet si:
  - Vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
  - Detyrimet reciproke mbi praktikatat e dëmeve. Trajtimi dhe pagesa e dëmeve.
7. Palët angazhohen të thellojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave nëpërmjet takimeve të ndërsjellta në funksion të rritjes së mëtejshme të standardeve në fushën e digjitalizimit dhe sigurisë kibernetike.

### Neni 3

#### **Kërkesa për Bashkëpunim**

1. Kërkesa për informim apo bashkëpunim nga Pala do të bëhet me shkresë zyrtare, apo postë elektronike dhe do t'i drejtohet perfaqësuesit të Palës tjetër në adresat e përcaktuara në këtë Memorandum.
2. Kërkesa për informacion apo bashkëpunim duhet të përmbajë:
  - a. llojin e informacionit apo bashkëpunimit që kërkohet;
  - b. një përshkrim të përgjithshëm lidhur me rastin konkret dhe arsyen përse kërkohet informacioni apo bashkëpunimi;
  - c. një përcaktim të personave, apo institucioneve që në dijeni të Palës kërkuese, mund ta kenë informacionin e kërkuar apo mund të bashkëpunojnë, ose ndonjë përcaktim tjetër të mundshëm për gjetjen e këtij informacioni apo asistence.



- d. dispozitat ligjore që lidhen me rastin konkret;
- e. afatin për marrjen e informacionit dhe bashkëpunimit duke specifikuar urgjencën nëse është e nevojshme.

#### **Neni 4**

##### **Trajtimi i Kërkesës dhe Komunikimi**

1. Shkëmbimi i informacionit apo kërkesa për bashkëpunim midis Palëve do të bëhet nëpërmjet shkresave zyrtare, ose postës elektronike në adresat e Palëve të përcaktuara në Aneksin A të këtij Memorandumi.
2. Përdorimi i informacionit për qëllime të tjera veç atyre të përcaktuara në kërkesë, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Palës që jep informacionin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Gjuha që do të përdoret nga Palët në zbatim të këtij Memorandumi është gjuha Shqipe.

#### **Neni 5**

##### **Konfidencialiteti**

1. Pala do ta përdorë informacionin e marrë nga Pala tjetër vetëm me qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore.
2. Ekzistenca dhe përmbajtja e çdo kërkesë për informacion apo bashkëpunim, e bërë në bazë të këtij Memorandumi, do të trajtohet si konfidenciale nga të dyja Palët, përveç rastit kur ato bien dakord ndryshe.
3. Veprimet nga Palët sipas këtij Memorandumi dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve dhe pjesëmarrja në inspektime/mbikëqyrje, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionet përkatëse të Palëve.

4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë sipas këtij Memorandumi, pa marrë më parë miratimin paraprak të Palës që jep informacionin.

## Neni 6

### Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Palët do të rishikojnë në mënyrë të vazhdueshme funksionet dhe efektshmërinë e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacioneve në bazë të këtij Memoradumi dhe do të konsultohen në rast të:
  - a. një mosmarrëveshje mbi kuptimin e çdo termi të përdorur në Memorandum dhe do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum Mirëkuptimi;
  - b. një ndryshim thelbësor në ligjet, rregulloret ose praktikat që ndikojnë në funksionimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe përbëjnë nevojën për amendim apo shfuqizim;
  - c. një propozim për t'u tërhequr nga Memorandumi i Mirëkuptimit; dhe
  - d. kurdoherë që është e nevojshme, me qëllim përmirësimin për funksionimin e tij dhe zgjidhjen e ndonjë çështjeje konkrete.
2. Ky Memorandum mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe me miratimin e të dyja Palëve.
3. Ky Memorandum lidhet me afat të papërcaktuar dhe mund të zgjidhet nga çdo Palë me kusht që Pala tjetër të njoftohet me shkrim 30 ditë përpara.
4. Palët do të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacione edhe gjatë 30 ditëve të njoftimit, deri në datën përfundimtare të zgjidhjes apo përfundimit të këtij Memorandumi.
5. Përfundimi apo tërheqja e njëres Palë nga ky Memorandum, nuk do të ketë efekt mbi detyrimet e Palëve në lidhje me informacionet konfidenciale të dhëna, osë të marra më parë në bazë të këtij Memorandumi.



**Neni 7**

**Hyrja në Fuqi**

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët, duke shfuqëzuar Memorandumin e mëparshëm në fuqi të vitit 2008.

Ky Memorandum, nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një kopje në original.

Nënshkruar në Tiranë, në datën:

21 / 10 / 2020

**Për Autoritetin e Mbikëqyrjes  
Financiare të Republikës së  
Shqipërisë**

**Për Bankën Qendrore  
të Republikës së Kosovës**

**ERVIN METE**

**Drejtore i Përgjithshëm  
Ekzekutiv**



**FEHMI MEHMETI**

**Gubernurator**

*NR. 2536 PROI  
DT 21.10.2020.*

 <b>BQK</b> Zyra e Gubernatorit Kabinet Gubernera Governor's Office	
E Dërguar: Përdato: Send to: <b>AMF</b>	
Data: Destur: Date: <b>23.10.20</b>	Nr. Br. Nr: <b>182-020</b>